

Република Северна Македонија
Министерство за економија и труд



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Ekonomisë dhe Punës

*Одделение за стратешко планирање
Njësia e planifikimit strategjik*



PLAN STRATEGJIK VITI 2025 – 2027

Shkurt, 2025



Të nderuar,

Plani Strategjik është dokument kompleks dhe gjithëpërfshirës që përmban masa dhe aktivitete të grupuara në programe dhe nënprograme, të cilat janë në funksion të arritjes së prioriteteve dhe qëllimeve strategjike të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës, e me këtë edhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Planifikimi strategjik është vegël që ka fuqinë, vizionin e krijuar për ta shndërruar atë në realitet. Ky realitet përmes planifikimit strategjik për shumë vite është zbatuar me sukses në Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës.

Me Planifikimin strategjik mundësohet realizimi i prioriteteve, qëllimeve dhe aktiviteteve që do të kontribuojnë në një ekonomi të zhvilluar funksionale, që do të prodhojë vende të reja pune, efikasitet më të madh, produktivitet dhe konkurrencë të kompanive, rritje të eksportit dhe rritje të investimeve, standard më të lartë jetese dhe jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Plani strategjik i Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës për tre vitet e ardhshme është kornizë për krijimin e kushteve për zhvillimin e industrisë, klasteringut, përfshirjen e kompanive maqedonase në rrjetin e zinxhirëve globalë të furnizimit, krijon masa dhe aktivitete për krijimin e sektorit të zhvilluar sipërmarrës, integrimin e tregut kombëtar në tregun e vetëm të BE-së, mbështetjen për punëdhënësit, krijimin e masave dhe politikave të punësimit, përmirësimin e tregut të punës dhe mbrojtjen e të drejtave të punës me qëllim përmirësimin e mjedisit afarist.

Në vitet e fundit janë bërë reforma kyçe në fushën e përmirësimit të klimës së biznesit në vend, përmirësimin e kushteve të punës së kompanive të huaja dhe vendore, si dhe përmirësimin e klimës afariste për investime të reja.

Të gjitha këto reforma bëhen përmes dialogut të vazhdueshëm me komunitetin e biznesit, shoqatat afariste, por edhe të gjitha institucionet shtetërore që janë krijuese dhe implementuese të politikave ekonomike, me njësitë e vetëqeverisjes lokale, komunitetin akademik, por edhe qytetarët.

Përmes dialog të njëjtë, tashmë janë përvijuar qëllimet për të cilat do të punojmë në mënyrë aktive në periudhën e ardhshme përmes programeve, projekteve, masave dhe aktiviteteve tona.

Cilat janë prioritetet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës në periudhën e ardhshme?

Me riorganizimin e ri, fokusi kryesor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës do të jetë mbështetja e industrisë, krijimi i masave për kompanitë mikro, të vogla dhe të mesme, rritja e konkurrencës së biznesit, tregu i brendshëm, tregtia, hotelieria, si dhe mbështetja e punëdhënësve, krijimi i masave dhe politikave të punësimit, përmirësimi i tregut të punës dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve.

Krijimi i klimës të favorshme afariste për sektorin e biznesit, para së gjithash përmes mbështetjes së ndërmarrjeve vendore, me fokus kryesor në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, hapjen e vendeve të reja të punës përmes investimeve të reja, zhvillimin dhe përmirësimin e konkurrencës së industrisë maqedonase, mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve përpunuese industriale që do të jenë të orientuara nga eksporti dhe do të krijojnë produkte me vlerë më të lartë të shtuar. Jo, më pak e rëndësishme për Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës



në periudhën e ardhshme, veçanërisht pasi Maqedonia e Veriut është anëtare e Aleancës së NATO-s dhe natyrisht fillimi i negociatave me Bashkimin Evropian, në dispozicion do të ketë një pjesë të fondeve paraaderuese nga buxheti i BE-së, si dhe Fondet strukturore dhe kohezive si instrument i rëndësishëm financiar i politikës rajonale të BE-së.

Realizimi i këtyre qëllimeve, të cilat janë në përputhje me prioritetet e përcaktuara strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të kontribuojë në sigurimin e rritjes së përsheptuar dhe të qëndrueshme ekonomike, një standard më të lartë të jetesës dhe cilësisë së jetës së qytetarëve.

Ministër i Ekonomisë dhe punës,
Besar Durmishi



HYRJE

Plani Strategjik si dokument afatmesëm strategjik, i lidhur ngushtë me procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit për një periudhë trevjeçare, paraqet instrument të rëndësishëm për planifikimin dhe monitorimin e zbatimit të Programeve në kompetencë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës. I përpiluar në bazë të Vendimit për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2024-2028, Programit të Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Programit Kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian.

MISIONI

Ministria e Ekonomisë dhe Punës punon në krijimin e kushteve për zhvillimin e industrisë, klasteringut dhe përfshirjes së kompanive maqedonase në rrjetën e zinxhirëve globalë të furnizimit, sektor i zhvilluar sipërmarrëse, zhvillim i hotelierisë, krijimin dhe integrimin e tregut të vetëm në BE, krijimin e masave dhe politikave për punësim, përmirësim të tregut të punës dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

VIZIONI

Republika e Maqedonisë së Veriut me ekonomi të zhvilluar funksionale që do të prodhojë vende të reja të punës, efikasitet më të madh, produktivitet dhe konkurrencë të kompanive, rritje të eksportit dhe rritje të investimeve, standard më të lartë jetësor dhe jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

DETYRA DHE OBLIGIME TË MINISTRISË SË EKONOMISË DHE PUNËS

Detyrat dhe obligimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me Ligj, kanë të bëjnë me:

- Monitorimi i gjendjes ekonomike, strukturore dhe tekniko-teknologjike dhe propozimi i masave për realizimin e zhvillimit dhe politikës aktuale ekonomike në fushën e tregtisë, marrja e masave kundër pozitës monopoliste dhe sjelljes monopoliste, ndjekjes së bilanceve aktuale materiale dhe furnizimit të qytetarëve me produkte ushqimore bazë dhe mallra të tjera të konsumit dhe ndërmarrje me lëndë të parë dhe repromateriale, sistemin dhe politikën e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve,
- Nxitja e ekonomisë cirkulare dhe qëndrueshmërisë së industrisë përpunuese;
- Krijimi i masave dhe politikave për punësimin, përmirësimin e tregut të punës dhe mbrojtjen e të drejtave të punës.
- Propozon politikë proaktive industriale për rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimit industrial dhe zhvillimin e sektorëve individualë të industrisë;
- Nxitje e investimeve përmes përmirësimit të klimës investuese;



- Rritja e rregullimit të tregut të brendshëm dhe liberalizimit të çmimeve, monitorimi i lëvizjeve dhe situatave në tregun e mallrae dhe shërbime dhe ndikimin e masave të politikës ekonomike në lëvizjet e tregut dhe marrëdhëniet e tregut; furnizimi i tregut me ushqime dhe produkte të tjera të konsumit , mbikëqyrja e tregut dhe mbrojtja e konsumatorëve dhe të drejtave të tyre;
- Nxitja e sipërmarrësisë dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe zejtarisë;
- Zhvillimi i hotelierisë,
- Mbikëqyrja administrative dhe çështje të tjera administrative të përcaktuara me Ligj;
- Koordinimi i Asistencës së Huaj dhe Programeve të Komunitetit (KOSME),
- Koordinimi dhe pjesëmarrja në grupet e punës brenda grupimeve, respektivisht Kapitujt e Kornizës negociatore, si Institucion bartës të 7 kapitujve dhe njëkohësisht si Institucion pjesëmarrës në më shumë se 20 Kapituj,
- Programimi, implementimi teknik dhe monitorimi i Projekteve IPA dhe koordinimi i asistencës tjetër të huaj me qëllim mbështetjen e tranzicionit dhe reformave në pjesën e kapitujve negociues që janë në kompetencë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës.
- Zhvillimi dhe nxitja e përgjegjësisë shoqërore;

SPECIFIKIMET E MINISTRISË SË EKONOMISË DHE PUNËS

Ministria e Ekonomisë dhe Punës, sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin, sipas Misionit të saj dhe Vizionit të përcaktuar propozon dhe realizon programe dhe projekte që lidhen me zhvillimin e disa segmenteve jetike ekonomike si industria, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, zejtaria, sipërmarrësia, tregtia, tregu i brendshëm dhe mbrojtja e konsumatorëve, hotelieria , integrimi evropian dhe aktivitetet e përgjegjësisë shoqërore, përmirësimi i tregut të punës dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve. Kjo përcakton specifikat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës për rritjen e pjesëmarrjes në programet dhe projektet horizontale në krahasim me organet e tjera të administratës shtetërore. Qasja horizontale është njëherësh edhe e ndërkombëtarizuar. Gjithashtu duhet të komunikojë me strategjitë afatmesme të Bashkimit Evropian, duke siguruar një qasje kombëtare. Kjo, nga ana tjetër, e thekson nevojën për avancim të vazhdueshëm të koordinimit inter dhe intra resorial, bashkëpunimit me komunitetin e biznesit, organet e vetëqeverisjes lokale, odat ekonomike dhe institucionet shkencore.



PRIORITETET DHE QËLLIMET E MINISTRISË SË EKONOMISË DHE PUNËS

1. Mbështetja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM)

- Mbështetja e ndërmarrjeve vendore, kryesisht ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) dhe zejtarëve,
- Përmirësimi i mjedisit afarist për rritjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM),
- Ekosistem dinamik të sipërmarrësisë dhe inovacioneve
- NVM-të konkurruese si nxitëse të rritjes gjithëpërfshirëse ekonomike

Zhvillimi dhe përmirësimi i konkurrencës së industrisë maqedonase, politikëm investuese dhe përgjegjësi shoqërore

- Zhvillimi dhe përmirësimi i konkurrencës së industrisë maqedonase
- Klima e përmirësuar afariste për të bërë biznes dhe forcimi i dialogut ndër-institucional në funksion të hartimit të politikave, masave dhe aktiviteteve të politikave industriale,
- Përmirësimi i shkathtësive dhe njohurive të ndërmarrjeve përmes trajnimit për teknologjitë e reja, sfidat e reja dhe kërkesat e tregut
- Mbështetja e industrisë përpunuese – zhvillimi i industrive të gjelbra duke vendosur konceptin e ekonomisë cirkulare dhe qëndrueshmërisë,
- Mbështetja e ekonomisë përmes zhvillimit, promovimit dhe implementimit të politikës investuese - Mbështetje financiare e investimeve,
- Mbështetje për forcimin e gatishmërisë eksportuese dhe promovimin e eksportit,
- Mbështetje për forcimin e bashkëpunimit akademik dhe të biznesit,
- Forcimi i kapaciteteve të laboratorëve për mbështetje më efektive të sektorit të biznesit,
- Avancimi i konceptit dhe praktikave të përgjegjësisë shoqërore.

3. Zhvillimi i hotelierisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

- Rritja e numrit të turistëve vendorë dhe të huaj, rritja e të ardhurave nga turizmi, me synimin përfundimtar rritjen e pjesëmarrjes së turizmit në PBB-në e përgjithshme të vendit.
- Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe bilateral në hotelieri,
- Mbështetja e destinacioneve turistike dhe objekteve hotelierike jashtë sezonit turistik,
- Mbështetja e objekteve hotelierike për përmirësimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara,



- Klima konkurruese e biznesit për rritjen e numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe vende të reja pune në fushën e hotelierisë,
- Zhvillimi i mëtejshëm i turizmit aktiv si potencial për zhvillim të fuqishëm ekonomik lokal,
- Përpilimi i Strategjisë kombëtare për zhvillimin e hotelierisë në vitet 2025-2030,

4. Krijimi i tregut të vetëm të brendshëm

- Avancimi i mbrojtjes së konsumatorëve me harmonizimin e mëtejshëm të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Zbatimi efikas i së drejtës në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve;
- Arritja e edukimit më të madh të konsumatorëve për realizimin e të drejtave të tyre, njohja e tregtarëve me të drejtat dhe obligimet dhe mënyrën e mbrojtjes së interesave ekonomikë;
- Rritja e besimit të konsumatorëve ndaj tregtarëve të mallrave dhe shërbimeve;
- Mbrojtja juridike e konsumatorëve gjatë lidhjes së marrëveshjeve për kreditë konsumatore si konsumator
- Harmonizimi i legjislacionit teknik kombëtar në fushën e automjeteve me legjislacionin teknik për automjetet e BE-së që rregullojnë tregun e brendshëm, në përputhje me rregullativën e BE-së

5. Zhvillimi i politikës efektive të tregtisë së brendshme

- Krijimi i klimës së favorshme afariste me politika të bashkëpunimit me sektorin afarist, mosdiskriminim, rritje të efikasitetit dhe transparencës së institucioneve dhe respektimin e plotë të shtetit të së drejtës
- Krijimi i politikave për tregtinë e brendshme, rregullimin e rregullave dhe masave për parandalimin e imponimit të praktikave të padrejta tregtare që deviojnë nga sjellja e mirë tregtare, rregullimin e kushteve dhe mënyrës së ushtrimit të tregtisë së brendshme, si dhe masat për ndalimin dhe kufizimin e zhvillimit të tregtisë, monitorimin dhe analizimin e lëvizjes së qarkullimit në tregtinë me shumicë dhe pakicë, lëvizjet, kushtet dhe fenomenet e tregut të produkteve ushqimore bazë, ndikimin e masave të politikës ekonomike në lëvizjet e tregut dhe marrëdhëniet e tregut, furnizimin e produkteve joushqimore dhe ushqimore për konsum të përgjithshëm, monitorimin dhe analizimin e lëvizjes së çmimeve në treg, si dhe propozimin e masave për zgjidhje sistematike dhe të tjera.
- Forcimi i procesit të planifikimit, përgatitjes dhe monitorimit të realizimit të Programit kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) si dokument bazë i programimit strategjik në procesin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në pjesën e së Drejtës së themelimit dhe lirisë së dhënies së shërbimeve.



6. Tregu i punës

- Nxitja e punësimit përmes krijimit të vendeve të denja të punës, krijimit të politikave në përputhje me praktikat evropiane dhe zhvillimit të dialogut social dhe mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve.
- Rritja e shkallës së punësimit dhe uljes së papunësisë;
- Përmirësimi i të drejtave të punëtorëve përmes legjislacionit të harmonizuar të punës në përputhje me direktivat e BE-së dhe konventat e ONP-së
- Dialog social i drejtë, transparent dhe i hapur ndërmjet komunitetit të biznesit dhe sindikatave
- Aktivizimi i grupeve të rrezikuara në tregun e punës
- Reduktimi i ekonomisë informale;
- Përmirësimi i sistemit të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, si dhe rritja e kapaciteteve për implementimin e tyre.

PASQYRË E REZULTATEVE TË ARRITURA NË VITET 2023/2024**1. PËRMIRËSIM I KLIMËS AFARISTE DHE RITJE TË KONKURRENCËS****Mbështetja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme**

Në vitin 2023, janë realizuar masat e mëposhtme nga Programi për zhvillimin e sipërmarrësisë dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për vitin 2023:

- ✓ Mbështetja financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (janë arritur 118 aplikime, janë subvencionuar 79 ndërmarrje me mjete në vlerë prej 19.833.724 denarë),
- ✓ Subvencionimi i shpenzimeve të zejtarëve (kanë mbërritur 40 aplikime, janë subvencionuar 31 zejtarë me mjete në vlerë prej 2.051.747 denarë),
- ✓ Mbështetja financiare për sipërmarrësinë e grave për digjitalizimin e proceseve afariste (kanë mbërritur 6 aplikime, është subvencionuar 1 ndërmarrje me mjete në vlerë prej 156.040 denarë),
- ✓ Mbështetja dhe zhvillimi i ndërkombëtarizimit të NVM-ve - me Vendimin për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet përdoruesve buxhetor[të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, masa është fshirë plotësisht,
- ✓ Bashkëfinancimi i projekteve për zhvillimin dhe promovimin e sipërmarrësisë dhe zejtarisë, si dhe aktivitetet programore të rrjeteve të engjëjve të biznesit (kanë mbërritur 19 aplikime/projekte, janë bashkëfinancuar 18 me fonde në vlerë prej 26.594.254 denarë),

Në vitin 2024, janë realizuar masat e mëposhtme nga Programi për zhvillimin e sipërmarrësisë dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për vitin 2024:

- ✓ Mbështetja financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (janë mbështetur 189 ndërmarrje në shumën totale prej 56.895.914 denarë).
- ✓ Subvencionimi i shpenzimeve të zejtarëve (janë mbështetur 37 zejtarë dhe ushtrues të veprimtarisë zeytare në shumën totale prej 5.694.502 denarë),
- ✓ Mbështetja financiare për sipërmarrësinë e grave për të hapur një kanal të ri të shitjeve onlajn (Nuk është publikuar Thirrje publike),
- ✓ Kompensimi i një pjese të kostove të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për certifikimin e sistemeve të cilësisë sipas standardeve ISO (janë mbështetur 9 ndërmarrje në shumën totale prej 537.337 denarë).
- ✓ Kompensimi i një pjese të shpenzimeve të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për certifikimin e sistemit HALLALL (janë mbështetur 5 ndërmarrje në shumën totale prej 445.260 denarë),
- ✓ Bashkëfinancimi i projekteve për zhvillimin dhe promovimin e sipërmarrësisë dhe zejtarisë, si dhe aktivitetet programore të rrjeteve të engjëjve të biznesit (janë bashkëfinancuar gjithsej 26 projekte në shumën totale prej 6.132.240 denarë).



- ✓ Bashkëfinancimi i një pjese të kostove për arsimimin e personave deri në 29 vjeç të punësuar në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (Nuk është publikuar Thirrja publike).

Është përgatitur Strategji për NVM-të 2025-2030 me asistencë konsulente nga DEU.

Është përgatitur Propozim - Ligji për nxitjen e investitorëve individualë – engjëj biznesi.

Zhvillimi dhe përmirësimi i konkurrencës së industrisë maqedonase dhe politika investuese dhe përgjegjësia shoqërore:

- ✓ Dokumenti i miratuar strategjik Strategjia për promovimin e eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2024-2027 me Plan veprimi, me qëllim të ngritjes së gatishmërisë për eksport dhe promovimit aktiv të eksportit
- ✓ Pjesëmarrje aktive në zhvillimin e Strategjisë së specializimit të mençur, si bazë për krijimin e një ekonomie të bazuar në njohuri, bashkëpunim më të madh të akademisë dhe biznesit për hulumtime dhe inovacione, mundësi të reja tregu
- ✓ Programi i realizuar për mbështetjen e konkurrencës së industrisë përpunuese për vitin 2023;
- ✓ Propozim ligji i ri për ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Zonat Industriale dhe të Gjelbra (versioni i punës),
- ✓ Implementimi i Ligjit për Produktet e Ndërtimit,
- ✓ Komunikimi i vazhdueshëm me KE përmes pjesëmarrjes në përgatitjen e NPAA Kapitulli 20 – Ndërmarrjet dhe politika industriale, pjesëmarrja e Nënkomitetit për Tregtinë, Doganat dhe Industrinë, monitorimi i vazhdueshëm i komunikimeve të reja me BE (projektet IPA, pjesëmarrja në zhvillimin e një strategjie të specializimit të mençur, etj.),
- ✓ Komunikimi i vazhdueshëm me sektorin e biznesit,
- ✓ Mbështetje e vazhdueshme administrative për realizimin e investimeve në ZZHTI Tetovë (partneritet publiko-privat).

Zhvillimi i hotelierisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

- ✓ Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe dypalësh në hotelieri
- ✓ Subvencione për objekte hotelierike
- ✓ Mbështetje e vazhdueshme për mjediset rurale, aktive dhe digjitalizimin e objekteve hotelierike

2. KRIJIMI I TREGUT TË VETËM TË BRENDSHËM

- ✓ Skrinin i përgatitur dhe realizuar me sukses për Kapitullin 28: Konsumatorët dhe Shëndeti Publik dhe Kapitulli 01: Lëvizja e Lirë e Mallrave.
- ✓ Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (G. Zyrtare e RMV-së , nr. 236/22) u miratuan këto akte:
- ✓ Programi i realizuar i mbrojtjes së konsumatorëve për vitin 2024 (G. Zyrtare e RMV-së , nr. 32/24)
- ✓ Programi i miratuar i mbrojtjes së konsumatorëve për vitin 2024 (G. Zyrtare e RMV-së , nr. 32/24)



- ✓ Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për autorizim të organit për mbrojtjen e interesave kolektive dhe të drejtave të konsumatorëve (G. Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.4/24);
- ✓ Rregullore për Listën e mallrave për të cilat nuk është e nevojshme të tregohet çmimi për njësi dhe lista e mallrave joushqimore ose kategoritë e tyre për të cilat tregtari është i detyruar të shënojë çmimin për njësi (G. Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.5/24);
- ✓ Është lëshuar aktvendim për autorizimin e organit për mbrojtjen e interesave kolektive dhe të drejtave të konsumatorëve
- ✓ Në përputhje me Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, janë miratuar me aktet e mëposhtme:
- ✓ Rregullore për mënyrën e njoftimit, si dhe mënyrën, kriteret dhe metodat për vlerësimin e rrezikut nga prodhuesit dhe shpërndarësit dhe formën dhe përmbajtja e formularit të njoftimit për produktet e rrezikshme të plasuara në treg nga prodhuesit dhe shpërndarësit (G. Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 219/23).

3. ZHVILLIMI I POLITIKËS EFEKTIVE TË TREGTISË SË BRENDSHME

- ✓ Ligji i miratuar për ndalimin e praktikave të padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore (*) (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 66 nga 20.3. të vitit 2024)
- ✓ Lista e produkteve bujqësore dhe ushqimore në bazë të të cilave përcaktohen praktikat e padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore (Gazeta zyrtare nr. 109 nga 27.05. të vitit 2024)
- ✓ miratoi Vendimin për ndalimin e shitjes së disa derivateve të naftës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr 84, më 12.04.2024).
- ✓ Vendim i miratuar për përcaktimin e listës së mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë (*) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 81, më 09.04.2024).
- ✓ Vendim i miratuar për përcaktimin e listës së mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë (*) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 121 më 13.06.2023).
- ✓ Implementimi i Ligjit për tregti
- ✓ Implementimi i Ligjit për duhanin dhe produktet e duhanit
- ✓ Implementimi i Ligjit për kontrollin e eksportit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë
- ✓ Implementimi i Ligjit për shërbimet
- ✓ Vendim i miratuar për përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 44/23).
- ✓ Vendimi i miratuar për përcaktimin e obligimit të tregtarëve për të prokuruar dhe shitur lloje dhe sasi të caktuara të mallrave të caktuara për konsumatorët sipas renditjes së caktuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.46/23)



- ✓ Vendim i miratuar për përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 52/23).
- ✓ Vendim i miratuar për përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 52/23).
- ✓ Vendim i miratuar për përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë dhe detyrimin e tregtarëve për të furnizuar dhe shitur lloje dhe sasi të caktuara të mallrave të caktuara të konsumatorëve sipas renditjes së caktuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.63/23)
- ✓ Vendim i miratuar për përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 70/23).
- ✓ Vendimi i miratuar për përcaktimin e obligimit të tregtarëve për të prokuruar dhe shitur lloje dhe sasi të caktuara të mallrave të caktuara për konsumatorët sipas renditjes së caktuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 74/23 dhe 92/23)
- ✓ Vendim i miratuar për përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 71/23, 78/23 dhe 92/23).
- ✓ Vendim i miratuar për kushte të veçanta për tregti me mallra të caktuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 135/22, 137/22, 206/22, 217/22, 283/22 dhe 91/23)
- ✓ Vendimi i miratuar i tregtarëve të ushtrojnë tregti me mallra të caktuara (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 192/23, 196/23 dhe 227/23).
- ✓ Vendim i miratuar për përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me shumicë dhe pakicë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.203/23 dhe 237/23).
- ✓ Vendim i miratuar për kushte të veçanta për tregtinë e mallrave të caktuara, me të cilin përcaktohet marzhi më i lartë tregtar (fitimprurës) si kusht të veçantë për tregtinë me fruta dhe perimeve të freskëta (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.203/23)
- ✓ Vendim i miratuar për kushte të veçanta për tregti me mallra të caktuara, përcaktim të çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë, si dhe detyrim të tregtarëve për të furnizuar dhe shitur lloje dhe sasi të caktuara të mallrave të caktuara të konsumatorëve sipas renditjes së caktuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 195/23, 202/23 dhe 203/23) dhe
- ✓ miratoi Vendimin për ndalimin e shitjes së disa derivateve të caktuara të naftës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr 84/2023).



4. TREGU I PUNËS

Aktivitetet e realizuara në gjysmën e parë të vitit 2024:

- ✓ Implementimi i masave të punësimit nga Plani operativ për programet dhe masat aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2024. Janë publikuar shpallje për shumicën e masave të punësimit dhe në rrjedhë është implementimi i tyre.
- ✓ U vazhdua me implementimin e Planit për garanci për të rinjtë në vitet 2023-2026 . Gjithashtu, në periudhën raportuese u vazhdua me implemetimin e Planit për implementimin e Garancisë për të rinjtë (GM) për periudhën e viteve 2023-2026. Gjatë vitit 2024 në gjithë vendin, respektivisht në periudhën e raportit janë përfshirë gjithsej 12.255 persona (6.024 gra), nga të cilat 3.568 janë të punësuar dhe 788 persona të përfshirë në disa nga masat aktive për punësim që nuk çojnë në punësim të drejtpërdrejtë, por rrisin punësinë e tyre. Sipas të dhënave dhe rezultateve, suksesi i Garancisë së të rinjve, në periudhën raportuese, arrin 38,9%, që tejkaloi parashikimin prej 30% të suksesit për periudhën e përmendur.
- ✓ Në gjysmën e parë të vitit 2024, u bë një përditësim me të dhëna të reja mbi 85 përshkrimet ekzistuese të profesioneve, dhe përshkrimi i 10 profesioneve të reja është në procedurë të përgatitjes.

Aktivitetet e planifikuara në gjysmën e dytë të vitit 2024:

- ✓ Vazhdimi i implementimit dhe realizimi i suksesshëm i masave të punësimit nga Plani operativ për programet dhe masat aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2024.
- ✓ Përgatitja e Planit të ri operativ për programet dhe masat aktive të punësimit dhe shërbimet e tregut të punës për vitin 2025.
- ✓ U vazhdua me implementimin e Planit për Garanci për të rinjtë në vitet 2023-2026 .
- ✓ Miratimi i Planit të ri të veprimit për punësim në vitet 2024-2027 me raport për realizimin e aktiviteteve në vitet 2021-2023.
- ✓ Përshkrim i përgatitur i 10 profesioneve të reja.

E drejta e punës

Aktivitetet e realizuara në gjysmën e parë të vitit 2024:

- ✓ Në mars u shpall paga minimale për Republikën e Maqedonisë për vitin 2024.

**PASQYRË E REZULTATEVE TË PRITURA NË VITIN 2025****PROGRAMI 1: PËRMIRËSIMI I KLIMËS AFARISTE DHE RITJA E KONKURRENCËS****Mbështetja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme**

- Realizimi i masave të parashikuara nga Programi për zhvillimin e sipërmarrësisë dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për vitin 2025.
- Plani i përgatitur i veprimit për strategjinë për NVM-të 2025-2030
- Duke filluar realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e re të NVM-ve 2025-2030, respektivisht Planin e veprimit.
- Ligji i miratuar për nxitjen e investitorëve Individualë – engjëjt e biznesit.

Zhvillimi dhe përmirësimi i konkurrencës së industrisë maqedonase dhe politikës investuese:

- Mbështetje për përmirësimin e konkurrencës së sektorit të biznesit përmes zbatimit të masave nga strategjia industriale, strategjia eksportuese, strategjia e specializimit të mençur, udhërrëfyesi i ekonomisë cirkulare
- Ndryshimi i rregullativës ligjore në përputhje me nevojat për riorganizim dhe krijimin e klimës më të mirë afariste dhe investuese dhe masa të reja mbështetëse
- Programi i realizuar për vitin 2024 dhe miratimi i Programit të ri për të mbështetur konkurrencën e industrisë përpunuese;
- Implementimi i Propozimit të ri për ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Zonat Industriale dhe të Gjelbra,
- Implementimi i Ligjit për Produktet e Ndërtimit,
- Komunikimi i vazhdueshëm me KE përmes pjesëmarrjes në përgatitjen e NPAA Kapitulli 20 – Ndërmarrjet dhe politika industriale, pjesëmarrja e Nënkomitetit për Tregtinë, Doganat dhe Industrinë, monitorimi i vazhdueshëm i komunikimeve të reja me BE (projektet IPA, pjesëmarrja në zhvillimin e një strategjie të specializimit të mençur, etj.),
- Komunikimi i vazhdueshëm me sektorin e biznesit,
- Mbështetje e vazhdueshme administrative për realizimin e investimeve në ZZHTI Tetovë (partneritet publiko-privat).

Mbështetja dhe zhvillimi i hotelierisë:**PROGRAMI 2. KRIJIMI I TREGUT TË VETËM TË BRENDSHËM**

**PROGRAMI 3: ZHVILLIMI I POLITIKËS EFEKTIVE TË TREGTISË SË BRENDSHME**

- Përgatitja e propozim-teksteve të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregti, Ligjit për kontroll të eksportit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë dhe Ligjit për kontroll të qarkullimit të jashtëm tregtar të diamanteve të papërpunuara, për shkak të harmonizimit me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 121, më 10.06.2024),
- Ndryshimi i akteve nënligjore sipas Ligjit për Tregti, Ligjit për Duhanin, Produktet e Duhanit dhe Produktet e Përafërta, me qëllim të respektimit të Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 121, më 10.06.2024),
- Përpilimi dhe miratimi i Urdhërësës për procedurën e njoftimit dhe vlerësimit të harmonizimit të të gjitha autorizimeve dhe kërkesave në propozim rregulloret e lidhura me qasjen në shërbimet dhe veprimtaritë shërbyese, me qëllim të implementimit të detyrimit të përfshirë në neni 35 të Ligjit për shërbime,
- Harmonizimi i Ligjit për tregtinë elektronike me legjislacionin më të ri të BE-së në fushën e tregtisë elektronike,
- Implementimi i Ligjit për ndalimin e praktikave të padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore (*),
- Implementimi i Ligjit për tregti
- Implementimi i Ligjit për e-tregti
- Implementimi i Ligjit për duhanin dhe produktet e duhanit
- Implementimi i Ligjit për shërbimet
- Koordinimi i Kapitullit 3.03 – E drejta e themelimit dhe liria për të dhënë shërbime,
- Koordinimi i Kapitullit 3.06- E drejta e shoqërive tregtare,
- Monitorimi dhe analiza e lëvizjes së qarkullimit në tregtinë me shumicë dhe pakicë, lëvizjet, situatat dhe fenomenet e tregut të produkteve ushqimore bazë, ndikimi i masave të politikës ekonomike në lëvizjet e tregut dhe marrëdhëniet e tregut, furnizimi i produkteve joushqimore dhe ushqimore për konsum të përgjithshëm, si dhe monitorimi dhe analizimi i lëvizjes së çmimeve në treg dhe propozimi i masave për zgjidhje sistematike dhe të tjera,



PROGRAMI 5: TREGU I PUNËS

- Do të vazhdojnë konsultimet me palët e interesuara në lidhje me finalizimin e tekstit të Ligjit të ri të marrëdhënieve të punës.
- Do të vazhdojnë edhe aktivitetet për përgatitjen e tekstit të Ligjit të ri për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Do të miratohet Ligji për angazhimin e thjeshtuar të punëtorëve për punë sezonale, të përkohshme dhe të kohëpaskohshme në veprimtari të caktuara.
- Brenda kornizës kohore, do të implementohen planet operative vjetore për programet dhe masat aktive të punësimit dhe shërbimet në tregun e punës
- Do të miratohet dhe implementohet Plan veprimi për punësim në vitet 2025-2027.



PROGRAME

Ministria e Ekonomisë në periudhën 2025-2027 do të zbatojë programet dhe nënprogramet e mëposhtme vertikale dhe horizontale me masa dhe aktivitete që janë në funksion të realizimit të prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe prioriteteve dhe qëllimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe punës.

Në Planin strategjik të punës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës janë krijuar këto programe strategjike:

I. PËRMIRËSIM I KLIMËS AFARISTE DHE RRYTJA E KONKURENCËS

- ❖ Mbështetja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- ❖ Zhvillimi dhe përmirësimi i konkurrencës së industrisë maqedonase dhe politikës investuese
- ❖ Mbështetja dhe zhvillimi i hotelierisë

II. KRIJIMI I TREGUT TË VETËM TË BRENDSHËM

- ❖ Mbrojtja e konsumatorëve dhe siguria e produkteve
- ❖ Siguria e automjeteve

III. ZHVILLIMI I POLITIKËS EFEKTIVE TË TREGTISË SË BRENDSHME

- ❖ Politika e tregtisë së brendshme
- ❖ Zbatimi i regjimit tregtar

IV. TREGU I PUNËS

PLANE PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE

A: ARSYETIMI DHE DIZAJNI I PROGRAMIT 1

Arsyetim: PROGRAMI 1 PËRMIRËSIM I KLIMËS AFARISTE DHE RITJE E KONKURRENCËS rezulton nga:

1. Prioriteti strategjik i Qeverisë së RMV-së i përfshirë në Vendimin për prioritetet strategjike për vitin 2024-2028:

-jetësimi ekonomik i vendit, avancimi i tranzicionit energjetik, nxitja e ciklit të fortë të rritjes ekonomike, financave të qëndrueshme publike, përmirësimin të infrastrukturës së përgjithshme transportuese, rritja e standardeve të jetesës, jetë më e mirë dhe më cilësore për të gjithë,

Qëllimi prioritar: forcimi i konkurrencës dhe mbështetja e industrisë përpunuese në ndërkombëtarizimin, inovacione, transformimin e gjelbër dhe digjital, mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të qëndrueshme dhe konkurruese mikro, të vogla dhe të mesme, promovimin e zejtarisë, përdorimin e plotë të frymës sipërmarrëse dhe njohuritë e burimeve njerëzore vendore, avancimin e progresit të kompanive në treg dhe digjitalizimin e bizneseve, promovimin dhe lehtësimin e klimës investuese dhe ndërkombëtarizimin e bizneseve, investimet në ekonominë e gjelbër dhe krijimin e vendeve të gjelbra të punës, mbështetjen e ekonomisë duke rritur investimet në hulumtim, zhvillim dhe inovacione, zhvillimin e hotelierisë.

1. NPAA : Kapitulli 20 - Ndërmarrjet dhe politika industriale

Kapitulli 20; Sektori: Turizëm dhe hotelieri; Tema: Turizmi si pjesë e politikës industriale

2. Prioritetet dhe qëllimet strategjike të organit të administratës shtetërore:

Mjedisi i favorshëm afarist:

Mbështetje për ndërmarrjet vendore, në radhë të parë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, hapje të vendeve të reja të punës dhe rritje të nivelit të pagave në ekonominë.

Mbështetje për ndërmarrjet vendore, në radhë të parë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, hapje të vendeve të reja të punës me masa aktive punësimi dhe rritje të nivelit të pagave në ekonominë.

Rritja dhe përmirësimi i mundësisë për rritje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM)

Ekosistem dinamik të sipërmarrësisë dhe inovacioneve

NVM-të konkurrense si nxitës të rritjes gjithëpërfshirëse ekonomike

Forcimi i dialogut ndër-institucional në funksion të krijimit të politikave, masave dhe aktiviteteve për politikën industriale

Avancimi i kapacitetit dhe konkurrencës së klasterëve dhe anëtarëve të tyre, lidhja e tyre ndërkombëtare, avancimi i njohurive të bazuara në teknologjitë e larta, hulumtim dhe zhvillim, strategjitë e orientuara nga eksporti dhe model i bazuar në industrializimin.



Rritja e konkurrencës së industrisë maqedonase,
 Rritja e mbështetjes për ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve,
 Mbështetja e bashkëpunimit shkencor dhe të biznesit në drejtim të specializimit të mençur,
 Mbështetje në krijimin e një klime të favorshme për investime,
 Mbështetja e investimeve për rritjen e konkurrencës, ekonomisë dhe punësimit,
 Mbështetje në tërheqjen e kapitalit të huaj dhe vendor për zhvillimin e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe për zhvillimin e teknologjive të reja dhe aplikimin e tyre në ekonominë kombëtare,
 Avancimi i konceptit dhe praktikave të përgjegjesisë shoqërore.

Zhvillimi i hotelierisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Rritja e numrit të turistëve vendorë dhe të huaj, rritja e të ardhurave nga turizmi, me synimin përfundimtar rritjen e pjesëmarrjes së turizmit në PBB-në e përgjithshme të vendit.

Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe bilateral në hotelieri,

Mbështetja e destinacioneve turistike dhe objekteve hotelierike jashtë sezonit turistik,

Klima konkurruese e biznesit për rritjen e numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe vende të reja pune në fushën e hotelierisë,

Zhvillimi i mëtejshëm i turizmit aktiv si potencial për zhvillim të fuqishëm ekonomik lokal,

